

Haiku van der Vegt (M), si një këshilltar strategjik për çështje gjeografike dhe të infrastrukturës së të dhënave hapësinore ka qenë përgjegjës për koordinimin e zbatimit të INSPIRE - Direktivës së kadastrës Holandeze dhe ishte anëtar i projektit "Korniza e vendndodhjes Evropiane (KVE)" e financuar nga Komisioni Evropian. Ai ka qenë i përfshirë në hartimin e projektit për dizajn, zbatimin dhe zhvillimin e gjeo-portalit kombëtar për shërbime publike për hartë (PDOK) që është pjesë e Infrastrukturës holandeze për të dhënat hapësinore. Si një ekspert në fushën e infrastrukturës të të dhënave hapësinore i përfshirë në zbatimin e SDI - projekte të mëdha në Butan, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Mozambik, Santa Luçia etj.

Haiku është një korrespondent i përhershëm i kadastrës holandeze EuroGeographics - Shoqatë Evropiane e agjencive kombëtare të hartave, kadastrës dhe regjistrimit të tokës, anëtar i grupeve të punës për filloristë / të dhënave themelore dhe të dhënat e integritit brenda Komisionit në Kombet e Bashkuara për menaxhim global të të dhënave gjeohapësinore (UN-GGIM). Ai ka një përvojë pune prej rreth 5 vjet si menaxher për biznes dhe marketing - komunikim në Eurogeografiks, në Francë. Ai aktualisht është menaxher në kadastrin holandez. Haiko është një hartograf dhe gjeograf i diplomuar dhe diplomën e ka marrë në Universitetin e Utrehtit, në Holandë.

Jandrick Bulance ka diplomuar në fushën e infromatikës dhe teknologjive të komunikimit dhe të gjeomatikës në vitin 1985 në Universitetin e Wageningen. Që nga viti 1990 ai ka punuar si specialist i GIS-it në Universitetin e Wageningen.

Ai është i përfshirë në projektet që fokusohen në aspekte të ndryshme të gjeoinformatave dhe anëtar i Komisionit për infrastrukturën e gjeoinformatave në komisionin gjeodezik në Holandë. Aktualisht ai është anëtar i INSPIRE - Ekspert i grupit punues tematik të tokës që synon përgatitjen e specifikimeve për të dhënat për shkëmbimin e të dhënave të tokës në Evropë.

Jandirk është specialist në infrastrukturën e të dhënave hapësinore (SDI) dhe është i përfshirë në projekte në Holandë, Rumani, Federatën Ruse, Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Etiopi. Ka punuar për "Geonium" si mbështetje për zbatimin e direktivës INSPIRE - në Holandë. Ka ndihmuar më tej në përgatitjen e një Studimi për të zgjeruar direktivën INSPIRE- modelet e të dhënave dhe standardizimin e tyre, si dhe në përgatitjen e Studimit për vlerësimin dhe evoluimin e ndarjes, vlerësimin e ndarjes dhe qasjes publike në të dhënat INSPIRE përmes autoriteteve publike.

Ai aktualisht është përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes të Komisionit Evropian për përcaktimin, identifikimin dhe prezantimin e praktikave më të mira të Bashkimit Evropian dhe menaxhimit kombëtar të sistemeve të informacionit të mjedisit jetësor dhe portaleve që janë përdorur për shpërndarjen aktive të informacionit të mjedisit jetësor në Bashkimin Evropian dhe shtetet e saj anëtare. Fokusi i angazhimit të tij në punë është përdorimi i të dhënave, modelimi i tyre, standardizimi, vizualizimi, shpërndarja, përdorimi dhe cilësia e të dhënave hapësinore. Të dëgjoen nevojat dhe kërkesat e përdoruesve, shfrytëzuesve, sipas tij, është faktori thelbësor për suksesin.